Kronikë

Plagosja e 24-vjeçarit në Durrës, në kërkim djali i xhaxhait! E qëlloi 3 herë me armë se i kaloi me shpejtësi pranë shtëpisë

Një 24-vjeçar në qytetin e Durrësit u paraqit mbrëmjen e djeshme në spital për të marrë ndihmë mjekësorë pasi ishte qëlluar në këmbë.

Foto/ nga vendi i ngjarjes

Redaksia
22 Maj, 08:50 | **Përditësimi: 22 Maj, 10:11**

Share

DURRËS- Një 24-vjeçar në qytetin e Durrësit u paraqit mbrëmjen e djeshme në spital për të marrë ndihmë mjekësorë pasi ishte qëlluar në këmbë. Rrethanat ishin ende të paqarta, por policia ka zbardhur ngjarjen dhe ka shpallur në kërkim djalin e xhaxhait.

Sipas uniformave blu, 24-vjeçari Eduart Buçeza është qëlluar me 3 herë me armë zjarri nga kushëriri i tij pas një sherri të çastit. Sherri agravoi për faktin se Eduard Buçeza kalonte në banesën pranë kushëririt me shpejtësi duke bërë që situata të agravonte deri në hapjen e zjarrit. Ngjarja ka ndodhur në shtëpinë e 24-vjeçarit në Shënavlash.

Policia ka shpallur në kërkim 33-vjeçarin Ilir Buçeza, kushëriri i 24-vjeçarit.

LEXO EDHE:
Pengmarrje në Durrës/ 4 të rinj rrëmbejnë 15 vjeçarin dhe e dhunojnë, policia ndërhyn për ta liruar

"Mbrëmjen e djeshme, pas marrjes së njoftimit se në Spitalin Rajonal Durrës ishte paraqitur për të marrë mjekim, shtetasi Eduart Buçeza, 24 vjeç, pasi ishte plagosur me armë zjarri, në këmbë, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës, në bashkëpunim me specialistët e Sektorit për Krimet e Rënda të DVP Durrës, shkuan menjëherë në vendin e ngjarjes, në oborrin e banesës së 24-vjeçarit, në fshatin Shënavlash, ku në drejtimin e prokurorit, kryen të gjitha veprimet hetimore për zbardhjen e rrethanave të rastit dhe identifikimin e autorit.

Nga veprimet e para hetimore rezultoi se autori i dyshuar është shtetasi Ilir Buçeza, 33 vjeç, banues në fshatin Shënavlash, i cili gjatë një konflikti të çastit, për motive të dobëta, ka plagosur me armë zjarri, në këmbë, djalin e xhaxhait të tij, shtetasin Eduart Buçeza, i cili vijon të jetë në spital, në kujdesin e mjekëve", njofton policia.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Durres | ilir buceza | eduart buceza | plagosje

Komento

Komente

Komshiu: 22/05/2024 11:07

Çfar do kërkojsh do gjeshë kështu ka erdh koha

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A ka qenë Vettingu i gjyqtarëve e prokurorëve proces i besueshëm?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Kroçera 'Monet' me turistë britanikë viziton sërish Durrësin (VIDEO)
22 Maj, 12:15

Në kërkim nga Bullgaria për tentativë vrasjeje, arrestohet në Portin e Durrësit 61-vjeçari nga Kosova
22 Maj, 09:57

Durrës/ 24-vjeçari plagoset me armë zjarri, paraqitet në spital! Rrethanat e paqarta
21 Maj, 22:59

Durrës, adoleshenti hajdut i baterive të makinave kapet duke vjedhur biçikletë
21 Maj, 13:54

E rëndë në Durrës/ Vajza 15 vjeçare denoncon të atin në polici, kreu marrëdhënie seksuale me të për 4 vite
21 Maj, 10:17

Basketboll meshkuj/ Besëlidhja 'vendos dorën' te titulli kampion, mposht Teutën në finalen e dytë
20 Maj, 13:39

Balla: Ngremë Zyrën e Rikuperimit të Aseteve që rrjedhin nga veprimtari kriminale, në përputhje me standardet e BE-së
20 Maj, 13:32

Zhduket 14-vjeçarja në Durrës, babai i të miturës denoncon në polici! Gjendet tek shtëpia e shoqes së saj
20 Maj, 11:22



Tentuan të 'pastronin' në treg 80 mijë euro të vjedhura në bankat e BE-së, 2 të arrestuar në Durrës (VIDEO)
20 Maj, 10:16

VIDEO/ Droni 'kap' parcelat me kanabis në mes të pyllit, pranga 53-vjeçarit në Krujë
20 Maj, 08:48

Nëntoka e Durrësit vijon të zbulojë thesare/ Dy mozaikët e gjetur tregojnë për një histori të paktën 1900 vjeçare

Aldo Mustafa
18 Maj, 13:41

Kush do vriste Durim Bamin? Detaje nga armiqësia me grupin e Shijakut
18 Maj, 13:25

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje